

PROCEDURAT QË NDJEKIN FUNKSIONARËT E LARTË PËR TË MARRË VENDIME

Procedurat janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në mbështetje të ligjit Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, nëpunësi më i lartë civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër është Sekretari i Përgjithshëm, i cili raporton dhe jep llogari drejtpërdrejt te Prefekti i Qarkut Shkodër. Funksonari më lartë në institucion është Sekretari i Përgjithshëm, i cili është përgjegjës për përcaktimin e objektivave të sektorëve përbërës, përcaktimin e detyrave të sektorëve përbërëse, për monitorimin e veprimtarisë së tyre dhe për sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre dhe me njësi të tjera të institucionit. Kompetencat dhe detyrat e funksionarëve të lartë ushtrohen në përputhje me Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe çdo legjislacion në fuqi për aq sa është i zbatueshëm. Lidhur me procedurat e zgjedhjes së tyre zbatohen dispozitat ligjore të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.